**SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE, SHOQËRISË**
**" DAS OIL " SHPK TIRANË**

**Për ushtrimin financiar të mbyllur më 31 Dhjetor 2022**

**TË PËRGJITHSHME DHE POLITIKAT KONTABEL**

Shoqëria "DAS OIL" shpk, u regjistrua si biznes në datë 30/10/2015 me administrator Z. Dritan Xhokaxhi, me objekt veprimtarie: Tregtimi me pakice te benzines, naftes, gazit, lubrifikanteve etj. Kjo shoqëri është regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT L52230020G

**MBI POLITIKAT KRYESORE TË KONTABILITETIT**

Pasqyrat financiare më 31 Dhjetor 2022 janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare" si dhe të ligjit 9228 datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin e pasqyrat financiare"

Kontabiliteti i shoqërisë " DAS OIL " shpk , është i organizuar rregullisht, i mbështetur mbi sistemin manual të mbajtjes të kontabilitetit , si dhe ata të informatizuar të cilat mundësojnë jo vetëm rregjistrimin e të dhënave por dhe marrjen e informacionit,respekton të gjitha kërkesat e Planit Kontabël,ligjin mbi Kontabilitetin dhe kërkesat e tjera ligjore. Llogaritë e ushtrimit financiar të vitit 2022 janë hartuar me hipotezën e vijueshmërise dhe janë zbatuar vlerësimet e parashikuara në këtë situatë.

Monedha në të cilën shprehen të gjitha pasqyrat financiare është leku shqiptar pa bërë rrumbullakime.

**VLERËSIMI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM**

Efikasiteti i kontrollit të brendshëm është i lidhur me sigurimin e mbrojtjes së pasurisë nga cdo lloj dëmtimi e shpërdorimi dhe në të njejtën kohë të sigurojë besnikërinë e informacionit administrativ, kontabël e financiar duke qenë i besueshëm nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhet edhe me pergjegjësinë e zbatimit të objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga përdoruesit.

Vendimarrja në lidhje me problemin e kontrollit të brendshëm lidhur edhe me përgjegjësinë e zbatimit te objekteve dhe parimeve të kontrollit duke filluar nga ndarja e punës, verifikimet dhe deri tek informimet, veprime këto që përgjithësisht në Entitet janë realizuar.

**SHËNIME MBI ZËRAT E LLOGARIVE NË PASQYRAT FINANCIARE**

**AKTIVI**
**AKTIVET MONETARE**

Në këtë pozicion të bilancit janë pasqyruar, aktivet monetare ne vlerën 18,566,046 **lekë**, përcaktuar në llogaritë në arkë dhe në bankë. Ka vijueshmëri në regjistrimin e dokumetave, përsa i takon datave dhe ka dokumenta justifikuese për veprimet e kryera. Diferenca e likuiditeteve për vlerën +7 876 082 lekë, e pasqyruar drejt në pasqyrën e fluksit monetar bashkangjitur bilancit, përputhet me pasqyrimin e tyre në aktiv te bilancit.

DAS OIL Sh.p.k.
NUIS : L 52230020 G
TIRANA - ALBANIA

| | |
|---|---|
| Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2021 | **10,689,964** lekë |
| Gjendja e likuiditeteve më 31.12.2022 | 18,566,046 lekë |
| Diferenca | +7 876 082 lekë |

## AKTIVE TË TJERA FINANCIARE AFATSHKURTËRA

**Të drejta të arkëtueshme të tjera në vlerën 1 824 513 582 lekë** ku përfshihen llogaria 411 "Kliente per mallra, produkte e sherbime" , 467 te debitoreve te tjere

## INVENTARI

**Inventari për vlerën 83 938 780 leke** ku përfshihet llogaria 35 **"Mallra"** dhe llogaria 327 "Te tjera-inventar i imet" dhe paradheniet per Inventar

## SHPENZIME TE SHTYRA

**Shpenzimet e shtyra për vlerën** 460,104,852 **lekë** ku përfshihet llogaria 486 **"Shpenzime të periudhave të ardhme "**

## AKTIVE AFATGJATA

**Aktive afatgjata materiale ne vleren 602,469,047 leke** ku perfshihen llogarite , llogaria 2051 "Projekte Teknologjike", llogaria 211 "Toka", llogaria 213 "Instalime teknike, makineri, pajisje, instrumente ", llogaria 215 "Mjete transporti", llogaria 2181 "Mobilje dhe pajisje zyre" llogaria 2182 "Pajisje informative", llogaria 2186 "Reklama,Tenda" ,llogaria 2818 "Perte tjera AA materiale" etj .

## PASIVI

## HUATË E PARAPAGIMEVE

Për vitin ushtrimor 2022 detyrimet në total janë në vlerën **2,983,814,583 lekë** që në mënyrë analitike janë si më poshtë :

**Detyrimet afatshkurtra** me vlerë totale **1,918,925,075.00 lekë**, ku përfshihen:
**Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit në vlerën** 1,732,289,403 **leke,** ku përfshihet llogaria 401 "Furnitorë për mallra, produkte e shërbime".
**Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore** në vlerën 3,261,361 **lekë,** ku perfshihet: llogaria 421 "Paga dhe shpërblime" 1 094 564 lekë dhe llogaria 431 "Sigurime shoqerore dhe shendetesore" 2,166,797 lekë.
**Të pagueshme për detyrimet tatimore** në vlerën 3,702,645 **lekë,** ku përfshihet llogaria 442 " Tatimin mbi të ardhurat personale "në vlerën 894,463 lekë dhe llogaria 449 "Tatim ne burim 1,047,937 lek , llogaria 4453 'TVSh parapaguar 1,760,244 leke.
**Të pagueshme te tjera** në vlerën 4,252,279 lekë ku përfshihet llogaria 409 " Arketime ne avance per porosi".
Titujt e huamarrjes afatshkurte ne vlere 175,419,387 leke

DAS OIL Sh.p.k.
NUIS : L 52230020 G
TIRANA - ALBANIA

**Detyrime afatgjata** ne vleren **1,064,889,508 leke** ku perfshihen detyrime ndaj institucioneve kreditore ne vlere 1,026,389,508 leke dhe obligacionet e shitura ne vlere 38,500,000 leke.

## KAPITALI

Gjendja e llogarive te Kapitalit dhe Rezervave të Shoqërisë në përfundim të periudhës është në vleren **5,777,724** dhe përbëhet nga Kapitali i nënshkruar për 100 lekë, fitimi i pashperndare ne vleren 5,575,185 leke dhe Fitimi i vitit ushtrimor 2022, marrë nga PASH, me vlerë 202,439 lekë.

## PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE

Për vitin 2022 Shoqëria "DAS OIL" shpk ka realizuar shpenzime në masën **3 103 313 513 lekë** nga veprimtaria e shfrytezimit. Shpenzimet janë si më poshtë:

**Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme** 2,918,703,359 **lekë** ku përfshihen: llogaria 605 "Blerje/shpenzime të materialeve".

**Shpenzimet e personelit : 112 157 916 lekë** ku përfshihen llogaria 641 "Pagat dhe shpërblimet e personelit" në vlerën 96,581,449 lekë dhe llog 644 "Sigurimet shoqerore dhe shendetesore" në vlerën 15,576,467 leke

**Shpenzime të tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit** 72,062,486 **lekë** ku përfshihen: llogaria 613 " Qira, llogaria 616 "Sigurime njesi shitje",llogaria 618 " Të tjera" ku perfshihen llogarite e sherbimeve noteriale, shpenzimet e konsulences, etj, llogaria 615 "Mirëmbajtje Stacione Karburanti" , llogaria 634 "Taksa dhe tarifa vendore", llogaria 638 "Tatime te tjera", llogaria 657 "Gjoba dhe demshperblime", etj.

Shpenzime per interesa te kredive bankare 175 466 leke

**Shpenzimet e tatim fitimit, llogaria 69,** për shumën 214,286 **lekë.**

## MBI TË ARDHURAT

Shoqëria ka realizuar të ardhura në masën **3 103 515 952 lekë** nga veprimtaria e shfrytëzimit ku perfshihet: Llogaria 705 "Shitje mallrash " në vlerën 3,092,450,425 lekë llogaria 708 " Të ardhura nga shtije te tjera-qera,lavazh" ne vleren 8,131,324 , Te ardhura te tjera 2,808,404 , llogaria 767 "Te ardhura nga interesi" dhe nga azhornimet e kurseve 125 799leke

**PËRLLOGARITJA E TATIM FITIMIT**

DAS OIL Sh.p.k.
NUIS : L 52230020 G
TIRANA - ALBANIA

| | |
|---|---|
| FITIM/(HUMBJA) E USHTRIMIT | **416,725** |
| SHPENZIME TE PANJOHURA | 0 |
| HUMBJE TE MBARTURA | 0 |

| | |
|---|---|
| TATIM FITIMI (15%). | 214,286 |
| FITIM/(HUMBJA) TATIMORE | **202,439** |

## PASQYRA E FLUKSIT TË PARAVE-Metoda Indirekte

Eshtë ndërtuar nga ana e jonë në përputhje me standartet kombëtare të kontabilitetit, bazuar në levizjet e mjeteve monetare të shoqërisë sipas kërkesave që ka vetë pasqyra dhe në perfundim rezulton:

Mjete monetare në fillim **10,689,962** lekë
Mjete monetare ne fund te periudhes **18,566,046** lekë
Rritja/rrenja neto e mjeteve monetare **+7 876 084** lekë

Pra, ka perputhje te plote te pasqyres te fluksit monetar dhe gjendjes te aktiveve monetare te vendosura ne aktiv te bilancit.

## PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

Eshtë plotësuar sipas kërkesave duke patur parasysh të gjitha ndryshimet e kryera midis dy periudhave ushtrimore dhe ku gjëndja e këtyre kapitaleve të vet shoqërisë në fund të periudhës paraqitet me një vlerë prej **5,777,724** lekë e cila paraqitet si në pasqyrën e ndryshimit të kapitaleve, po ashtu edhe në postin e kapitaleve në pasiv të bilancit 2022.

## SHËNIME TË TJERA SHPJEGUESE

Ngjarje të tjera të ndodhura pas datës të bilancit për të cilat bëhen rregullime apo ngjarje të ndodhura pas datës të bilancit që nuk bëhen rregullime,nuk ka.

Duke patur parasysh shënimet e mësipërme, paraqitim të gjitha aspektet, të gjendjes financiare të shoqërisë deri më 31.12.2022.

**Tiranë , më 31.03.2023**

**Administratori**
**Dritan Xhokaxhi**

DAS OIL Sh.p.k.
NUIS : L 52230020 G
TIRANA - ALBANIA